



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 15/2010

Prishtinë më 13.04.2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Zef Morina, Qamile Morina, Fatmir Rexhepi, Mufeta Sinik, Nerxhivane Dauti dhe Kaqusha Jashari.

Mungoi: Mursel Haljilji.

Pjesëmarrës të tjerë: Avdi Kamerolli dhe Enver Basha – MTPT, Bill Klaëonn dhe Haxhi Gashi – USAID, Besim Zeqiri – ICO, Visar Ramaj – KDI dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi Mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të datës 30. 03. 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik nr. 03/L-166,
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Sala Berisha – Shala – Propozoi që pika e 4 (katërt) të vendoset në vend të pikës së 3 (tretë) të rendit të ditës, sepse në pikën e 3 (tretë) do të këtë debat për çështjet e hapura që kanë mbetur.

Propozimi u miratua njëzëri nga Komisioni, që të diskutohet më këtë:

R e n d d i t e

1. *Miratimi i rendit të ditës,*
2. *Miratimi i procesverbalit të mbajtur më 30. 03. 2010,*
3. *Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik nr. 03/L-166,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163,*
5. *Të ndryshme.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30. 03. 2010

Kryetarja – I njoftoi deputetët se për këtë mbledhje është hartuar një transkript i mbledhjes së kaluar, ndërkaq në mbledhjen e radhës do të hartohet procesverbali i mbledhjes së datës 30. 03. 2010, duke u bazuar në këtë transkript.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik nr. 03/L-166

Kryetarja – I njoftoi deputetët se Raportin e Projektligjit nr. 03/L-166 për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik do ta paraqesë kryesuesja e Grupit punues, znj. Nerxhinave Dauti.

Nerxhinave Dauti – E paraqiti Raportin e grupit punues për Projektligjin nr. 03/L-166 për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, si në vijim: Amendamenti 1 ndryshon preambulën edhe titullin e Projektligjit; Amendamenti 2 riformulon nenin 2; Amendamenti 3 riformulon paragrafin 1, nënparagrafët 1.6.1 dhe 1.6.2, të nenit 3; Amendamenti 4 ndryshon titullin e nenit 4; Amendamenti 5 ndryshon paragrafët 1 dhe 2 të nenit 8; Amendamenti 6 riformulon paragrafin 1 të nenit 9; Amendamenti 7 ndryshon nenin 10; Amendamenti 8 riformulon paragrafët e nenit 11; Amendamenti 9 ndryshon nenin 12; Amendamenti 10 ndryshon paragrafin 4 të neni 13 -të; Amendamenti 11 ndryshon paragrafin 2 të nenit 14; Amendamenti 12 ndryshon paragrafin 2 të nenit 15; Amendamenti 13 ndryshon paragrafët 1 dhe 2 të nenit 16; Amendamenti 14 ndërhynte në neni 28.

Amendamenti 1

Nerxhivane Dauti - Theksoi se edhe gjatë procesit të amendamentimit të këtij projektligji kemi pasur dilema rreth titullit, mirëpo pas konsultimit edhe me ekspertë të kësaj fushe kemi ardhur në përfundim se shprehja parandalim mund të fshihet nga titulli i Projektligjit. Po ashtu kjo bie edhe në harmoni me kodin penal, sepse me të thuhet vetëm luftimi i veprave penale, e jo parandalimi, ku me luftim nënkuptohet edhe parandalimi ose preventiva e një veprë penale. Gjithashtu ajo propozoi që të hiqet nga preambula teksti që fletë për qëllim të ligjit nga se qëllimi është përfshi me neni 1.

Pas debatit Komisioni u pajtua pjesërisht me amendamentin e parë. Titulli mbetet ashtu sikurse është propozuar me Projektligj, ndërsa teksti i fjalës së dytë hiqet sepse është standard që preambula të përmbajë vetëm autoritetin kompetent dhe bazën juridike për nxjerrej e Ligjit.

Amendamenti 2

Përfaqësuesi i ministrisë – Nuk u pajtua me riformulimin e nenit 2, sepse ky projektligj, sipas tij, është kufizuar vetëm brenda sistemit kompjuterik në Kosovë, e jo fushën e teknologjisë së informimit dhe komunikimit, dhe se se kësaj fushe i referohet një ligj tjetër.

Pas debatit Komisioni u pajtua që neni 2 të mbetet ashtu sikurse ishte në Projektligj.

Nerxhivane Dauti – Në fund e falënderoi koordinatorin dhe Stafin Mbështetës të Komisionit, për profesionalizimin dhe ofrimin e mbështetjes tekniko – administrative si dhe grupin punues në hartimin e këtij Raporti me amendamente.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Përfundim

I. Miratohen 13 amendamente së bashku me Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik nr. 03/L-166,

II. Amendamentet e miratuara janë pjesë e këtij procesverbali.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163

Kryetarja – Theksoi se kryesuesja e grupit punues për Projektligjin për miniera dhe minerale nr. 03/L-163, znj. Sala Berisha – Shala, paraqet amendamentet që kanë mbetur të hapura për debat.

Sala Berisha – Shala – Theksoi se në Kosovë nuk ka Shërbim Gjeologjik. Detyrat dhe përgjegjësitë e SHGJK- së aktualisht janë ndërmarrë nga disa subjekte të ndryshme

qeveritare si MEM, KPMM, MMPH, etj. Ku duhet të jetë SHGJK-ja? Duke u nisur nga fakti që Kosova është shtet i ri dhe i duhet një dinamizëm me i shpejtë i zhvillimit ekonomik; e për këtë përgjegjës kryesor është dega ekzekutive – Qeveria; SHGJK-ja, si organ hulumtues shkencor – mineral, do duhej të jetë në varësi të ekzekutivit, sepse drejtpërdrejt do ta furnizojë Qeverinë me të dhëna shkencore, zhvillimore, hulumtuese në lidhje me resurset natyrore, minerare, që janë në funksion të zhvillimit dinamik të ekonomisë ose kërkojnë urgjencë të riaktivizimit të kapaciteteve gjeologe – minerare, e që mund të jenë katalizatorë i fuqishëm të zhvillimit të sektorit gjeologji – xehetari - industri. Po ashtu SHGJK-ja, Qeverinë do ta pajisë me informacionin rreth rezervave me kapacitet mineral. Mbështetur në këto që u thanë, përveç që këto të dhëna do tërhiqnin edhe investitorë potencialë për industrinë në përgjithësi, e në veçanti industria minerare. Në të kundërtën, nëse Shërbimi do mbetej si Agjenci, i themeluar nga Kuvendi, asnjë mekanizëm nuk do mund të kontrollonte, analizonte, ose t'i funksionalizonte të dhënat shkencore hulumtuese në mënyrë të mirëfilltë në funksion të zhvillimit të shtetit. SHGJK-ja do të kalonte në një Agjenci larg zhvillimit, larg përgjegjësi dhe larg kontributit zhvillimor ekonomik duke i raportuar një herë në vit Kuvendit, siç po ndodh me Agjencitë e tjera, që më një raport vjetor në Kuvend, përmbyllin tërë aktivitetin e vet në funksion të shtetit, zhvillimit ekonomik të tij. Vendet me ekonomi stabile, prioritet në kuadër të Qeverisë, i japin ShGjK- së dhe e kanë parametër për planifikim ekonomik. Me fjalë të tjera, themelimi i ShGjK- së do të shprehet me përmirësimin e vazhdueshëm të problematikës kërkimore shkencore dhe aplikative në përputhje me kërkesat e tanishme dhe perspektive të shoqërisë. Studimet gjeologjike, e thënë më shkurt, nga thjesht si paraprijëse të industrisë nxjerrëse do zgjeruar në fushën studimore, duke i dhënë përparësi veprimtarisë shkencore - aplikative, që ndihmojnë zhvillimin ekonomik të vendit me ndikime sociale të drejtpërdrejta. Pa nënvlerësuar zhvillimin e gjeologjisë bazë të trashëguar do të intensifikohet puna në specialitete të gjeologjisë së aplikuar duke integruar në veprimtari infrastrukturore në ndërtim, transport, urbanistikë, bujqësi, turizëm, mbrojtje nga ndotjet e rreziqet natyrore, etj. ShGjK-ja do të ofrojë *“Këshilla të paanshme gjeoshkencore dhe të cilësisë së sigurt, dhe informata për partnerë të shumtë ku përfshihen Qeveria, opinioni publik dhe industria”*. ShGjK-ja duhet të jetë i pavarur dhe të themelohet si Agjenci publike kërkimore. Ministria raportuese/përgjegjëse duhet të jetë ajo e Energjisë dhe Minierave. Shërbimi Gjeologjik Britanez ka rekomanduar modelin në faza të themelimit të Shërbimit Gjeologjik të pavarur duke shfrytëzuar një marrëdhënie fillestare të ngushtë me MEM, investime të mëdha në kapitalin njerëzor dhe ndërtimin e kapaciteteve përmes MEM dhe pastaj, pas një periudhe të caktuar prej pesë vjetëve, bartja tërësisht në një organ të pavarur. Formimi i Shërbimit Gjeologjik do të ketë ndikime pozitive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Themelimi i Shërbimit Gjeologjik do të sjellë rezultate në drejtim të: a) rritjes së koeficientit të hulumtimeve të parapara (planifikuara) dhe rrjedhimisht mundësitë e zbulimeve të reja të mineraleve të dobishme, b) Vlerësimit real të rezervave të pasurive natyrore, konform standardeve të sotme, menaxhimit shkencor dhe të qëndrueshëm, c) Të dhënat e reja dhe informacioni shkencor do të ketë përmirësime cilësore dhe besueshmëri më të lartë. Ai do të sistemohet në kuadër gjeodetobazës të GIS-it, do të ketë qasje të shpejtë në procesin e vendimmarrjes. Produktet shkencore (studime, projekte hulumtimi, harta gjeologjike, monografi, etj.) do të jenë në përdorim të drejtpërdrejtë të organeve të planifikimit si dhe subjekteve të ndryshme shtetërore e private, d) Studimet mbi pasuritë

natyrore vendosen më pranë kërkesave të shoqërisë dhe të shtetit, duke krijuar mundësi dhe premisa të favorshme për zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë, e) Aplikimit të teknologjive të reja të hulumtimit dhe shfrytëzimit të mineraleve të dobishme etj. Pastaj elaboron përvojat e Shërbimit Gjeologjik të regjionit dhe më gjerë janë si vijon: *Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)* është person juridik publik, buxhetor, organ këshillimor teknik i shtetit, që me porosi të tij kryen veprimtari gjeologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë (*Neni 4*). SHGJSH është në varësi të ministrit dhe ka selinë e tij qendrore në Tiranë. *Neni 5* Shteti i përfaqësuar nga ministria, është zotërues i vetëm i kapitalit të SHGJSH- së dhe ushtron të drejtën e tij si pronar në përputhje me legjislacionin në fuqi); *Instituti i Gjeologjisë – Kroaci, Neni 2* Themeluesi i Institutit Gjeologjik Kroat është Republika e Kroacisë, të drejtat dhe detyrat e themeluesit do të bëhen nga Ministria e Shkencës, Arsimit dhe e Sportit; *Instituti Gjeologjik i Malit të Zi*, Instituti për Hulumtime Gjeologjike i Malit të Zi është institucion shtetëror në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, e cila merret me hulumtime gjeologjike; *Instituti gjeologjik i Rumanisë*, nga viti 1996 është instituti kombëtar për kërkime dhe zhvillim të gjeologjisë, gjeofizikës, gjeokimisë në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Autoriteti Kombëtar të Kërkimit Shkencor. Në strukturën organizative të Institutit është edhe Muzeu Kombëtarë i Gjeologjisë; *Instituti gjeologjik i Bullgarisë*, sipas Rregullores për themelimin e Institutit të Gjeologjisë së Bullgarisë *Neni 1* Themelohet Instituti i Gjeologjisë në kuadër të Akademisë së Shkencave (29.06.1992); *Shërbimi Gjeologjik i Finlandës*, SHGJF vepron në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të punësimit, është shërbim kombëtar për gjeologji; *Shërbimi Gjeologjik i Irlandës* SHGJI - është Agjenci kombëtare për hulumtime gjeologjike, është në kuadër të Ministrisë Komunikimit, Energjisë dhe Burimeve natyrore; *Shërbimi Gjeologjik i Estonisë*- Nga viti 1993 Shërbimi Gjeologjik i Estonisë vepron në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, është kompani publike; *Shërbimi Gjeologjik Lituanisë* SHGJL vepron në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, si shërbim nacional etj. Shembuj, që shpresoj që do të mjaftojnë se si dhe ku jemi ne, sa i përket SHGJK - së. Dhe në fund kërkoj edhe njëherë nga Kryetarja që ta hedhë në votim versionin e tillë që SHGJK të jetë në MEM.

Ibrahim Krasniqi (konsulent i Komisionit) – Theksoi se duke u bazuar në ekspertizën e tij të pavarur nuk pajtohet që Shërbimi Gjeologjik i Kosovës të mbetet në kudër të MEM, sepse ky shërbim ka impakt edhe te ministrinë e tjera MAPH dhe MASHT.

Fatmir Rexhepi - Theksoi se nuk duhet të jetë Shërbimi Gjeologjik në kuadër të Kuvendit, mirëpo propozoi që Qeveria ta nxjerrë një rregullore të veçantë, ku duhet t'i përcaktojë të drejtat dhe detyrat e këtij shërbimi.

Ethem Çeku – Theksoi se duke e marrë parasysh situatën që po rrjedh deri më tani, sikurse që ka ndodhur me çështje e tjera, të gjitha Agjencitë, edhe kjo që do të themelohet, do të jetë e varur nga politika. Në takimet e kaluara kemi kërkuar që të kemi përvojat e vendeve të tjera dhe në bazë të kësaj analize secili shtet e ka formën e vet të rregullimit ndryshe nga shteti ose vendi tjetër. Krejt në fund theksoj se nuk e mbështet qëndrimin që Shërbimi Gjeologjik i Kosovës të jetë në kuadër të Qeverisë, por propozoi që ai të jetë i pavarur.

Bill Klawonn (USAID) – Theksoi se nëse Shërbimi Gjeologjik i Kosovës do të mbetet në kuadër të MEM-it, do të duhet të përfshihet me dispozitë që drejtorin ta zgjedhë Kuvendi, sepse në këtë mënyrë ky shërbim do të mbrohet nga ndërhyrjet politike.

Kaqusha Jashari – Theksoi se duke marrë parasysh praktikën e deri tanishme të Agjencive ka dalë se ato nuk kanë pasur obligim ndaj askujt dhe vetëm një herë në vit kanë raportuar në Kuvend. Ajo propozoi që kjo Agjenci të quhet Institut, sepse ka të bëjë më hulumtime dhe ka shumë më pak punë ekzekutive, andaj ideja më e mirë qëndron që të jetë në kuadër të MEM - it.

Sala Berisha Shala – Theksoi se propozimi i Billit nuk është logjik dhe është jashtë praktikës që ta vendosi Kuvendi drejtorin e një agjencie. Drejtorin duhet ta vendosë Qeveria, sepse ka panel më profesional, andaj ne duhet t'i ikim praktikave të vendeve të tjera dhe të veprojmë në bazë të logjikës së shtetit tonë.

Qamile Morina - Theksoi se shërbimi duhet të mbetet në kuadër të Kuvendit dhe t'i raportoj Kuvendit, sepse ky Shërbim duhet të krijojë programe dhe politika shtetërore në kushte racionale për shfrytëzimin e resurseve gjeologjike, dhe t'ia paraqes Kuvendit një dokument që ta miratojë atë Planpropozim.

Zef Morina –Theksoi se e përkrah propozimin e Billit dhe propozoi që ky shërbim të quhet institut e jo agjenci.

Kryetarja - Propozoi një kompromis që Shërbimi Gjeologjik të mbetet në kuadër të METM - it, mirëpo drejtorin ta zgjedhë Komisioni ynë, pasi që Qeveria të propozojë 4 (katër) individë të kësaj fushe.

Pas debatit Komisioni me 5 (pesë) vota” për” dhe 2 (dy) kundër dhe 1 (një) abstenim, nxori këtë

Përfundim

I. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës të emërtohet: “Instituti Gjeologjik i Kosovës”, të sistemohet në kuadër MEM-it ndërsa drejtori të propozohet nga Qeveria dhe zgjedhjen ta bejë komisioni i Kuvendit për ETIETT.

II. Të behet përkufizimi i “kristaleve” si dhe në kuadër të nenit 74 ekzistues të hartohet një paragraf me të cilin do autorizohet ministria të nxjerr një akt nënligjor me të cilin do rregullohet siguria dhe mbrojtja e kristaleve në një muze nacional.

III. Autorizohet grupi punues që me ndihmen e ekspertëve të hartohen amendamentet lidhur me pozitën juridike të Shërbimit gjeologjik të Kosovës dhe me definimin e nocionit “kristal” dhe ruajtjen e tyre në pajtim me përmbajtjen e miratuar nga Komisioni.

IV. Amendamentet i dorëzohen stafit të administratës për Komision, i cili autorizohet që t'i procedoi më tutje sipas Rregulorës së punës së Kuvendit.

5. Të ndryshme

i) Shqyrtimi i projektligjeve dhe raporteve vjetore të agjencive të pavarura

Kryetarja – Kërkoi të njoftohet Fatmir Rexhepi që të përshpejtohet puna e grupit dhe të paraqitet Raporti me amendamente në Komision, për Projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara nr. 03/L-165. Raportues për Projektligjin për inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese nr. 03/L-181, caktohet Nerxhivane Dauti. Ndërkaq për Projektligjin për energjinë nr. 03/L-184, Projektligji për energjinë elektrike nr. 03/L-201, dhe Projektligji për rregullatorin e energjisë nr. 03/L-185, raportuesit do të caktohen në mbledhjen e radhës. Po ashtu njoftoi Komisionin që kanë për shqyrtim raportet vjetore të agjencive të pavarura, si Raporti Vjetor për AKP - në, KPM - në, ZRRE - në, KKK - në dhe AAC - në.

ii) Mbledhja e radhës

Kryetarja – Propozoi që në mbledhjen e radhës të shqyrtohet Projektligji për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara nr. 03/L-165 raportues: Fatmir Rexhepi.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Në mbledhjen e radhës të shqyrtohet Projektligji për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara nr. 03/L-165, raportues Fatmir Rexhepi.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 00.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani